



Lugano, 11 Prill 2026

**Nga:** **MABCO CONSTRUCTIONS SA**  
Rr. Via Cattori 7, 6902 Paradiso, Lugano, Zvicër  
Përfaqësuar nga z. Emin Pacolli, Kryetar i Këshillit të Administrimit

**Drejtuar:** **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë  
Në vëmendje të Ministrit, z. Enea Karakaçi  
Në vëmendje të Sekretarit të Përgjithshëm, z. Besjan Kadiu

**Për dijeni:** **Kryeministria**  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë  
Në vëmendje të Kryeministrit, z. Edi Rama

**Banka Kombëtare Tregtare sh.a**  
Rr. e Vilave, Lundër 1, Tiranë, Shqipëri  
Në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm z. Seyhan Pencabligil

**Vlora International Airport sh.p.k**  
Në vëmendje të z. Vegim Hoxha

**2A Group sh.p.k**  
Rruga "Ali Pashë Tepelena", nr. 1/14 IVY Residence, Prishtinë  
Në vëmendje të administratorit z. Kushtrim Krivaqa

**2A Group, degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri e 2A Group sh.p.k.**  
Rruga "Faik Konica", Pallati 6, Shkalla 5, Zyra 7, Tiranë  
Në vëmendje të Administratorit, z. Valon Ademi

**Ambasada e Zvicrës në Republikën e Shqipërisë**  
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 3/, 1019 Tiranë  
Në vëmendje të Shkëlqesisë së saj Zj. Ruth Haber

**Lënda:** **Njoftim zyrtar i shkeljes së Kontratës së Koncesionit nga  
Autoritetet Kompetente dhe kërkesë shtyrjeje afatesh**



**mabco constructions s.a.**  
Via Cattori 7, 6902 Lugano Switzerland

Tel. +41 (0)91 985 01 01  
Fax +41 (0)91 993 06 36

info@mabetex.com  
www.mabetex.com

**I nderuar Z. Ministër,**

Mabco Constructions SA ("**Mabco**") i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ("**Ministria**") në vijim të mbi tridhjetë shkresave të dërguara gjatë tetë muajve të fundit drejtuar Ministrisë, Kryeministrisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, të cilat, pa përjashtim, kanë mbetur pa asnjë përgjigje ose ndërhyrje. Kjo shkresë shërben njëkohësisht si: (i) njoftim zyrtar i shkeljes së nenit 11.9 nga Autoritetet Kompetente (gjykatat) dhe kërkesë shtyrjeje afatesh sipas nenit 11.10; (ii) njoftim i Ngjarjes së Forcës Madhore sipas nenit 12, si bazë kumulative; (iii) njoftim i Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar sipas nenit 13 dhe kërkesë formale për takimin sipas nenit 13.3; si dhe (iv) përgjigje ndaj shkresës suaj Nr. 2535 prot., datë 8 prill 2026 ("**Letra e MIE-s**").

Mabco thekson se Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka detyrimin ligjor dhe kontraktual të ushtrijë mbikëqyrje aktive mbi zbatimin e Kontratës së Koncesionit ("**Kontrata e Koncesionit**"), në përputhje me nenin 32 të Ligjit Nr. 125/2013 "*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*", i cili kërkon kontroll dhe miratim të çdo ndryshimi që ndikon në strukturën e koncesionarit; nenin 18 të Kontratës së Koncesionit, i cili parashikon detyrimin e miratimit paraprak të çdo transferimi kuotash apo ndryshimi në strukturën aksionare; si dhe parimet e administrimit publik dhe të bashkëpunimit me mirëbesim ndërmjet palëve kontraktuese. Heshtja dhe mosveprimi i Ministrisë, gjatë gjithë kësaj periudhe, nuk përbën vetëm mungesë reagimi administrativ, por edhe dështim të hapur në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe kontraktual të Autoritetit Kontraktues.

Kjo heshtje e vazhdueshme ndaj shkresave të Mabco-s përbën, mbi të gjitha, **shkelje të parimit të mirëbesimit**, i sanksionuar shprehimisht në nenin 422 dhe 674 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 24 pika 9 i Kontratës së Koncesionit. Sipas këtyre dispozitave, palët e një kontrate kanë detyrimin pozitiv të bashkëpunojnë, të komunikojnë dhe të sillen me korrektësi dhe paanësi gjatë gjithë ekzekutimit të marrëdhënies kontraktuale. Refuzimi *de facto* i Ministrisë për t'iu përgjigjur shkresave të Mabco-s, duke lënë pa adresuar shqetësime kritike lidhur me sigurinë e pistës, uzurpimin e VIA-s dhe kushtet për nisjen e operimit, është sjellje plotësisht e papajtueshme me këtë detyrim.

Për t'u qartësuar plotësisht mbi natyrën dhe shtrirjen e komunikimeve tona të ngeluar pa përgjigje, Mabco paraqet si vijon listën jo shteruese të çështjeve konkrete për të cilat Ministria është njoftuar nga Mabco në vazhdimësi, por ndaj të cilave nuk ka ndërmarrë asnjë veprim:

- Tentativën e grabitjes së 47% të kuotave të shoqërisë që i zotërohen Mabco-s nga ana e 2A Group sh.p.k. ("**2A Group**"), të dokumentuar dhe të denoncuar herët në krye të konfliktit;



- Vendimin nr. 996, datë 17.10.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (“**Vendimi i Parë**”), me të cilin pezullohej e drejta e votës së Mabco-s, si dhe mënyrën se si kjo masë paralizoi VIA-n, duke e lënë pa administrator legjitim për dy muaj të plotë;
- Provat e vazhdueshme mbi pretendimet propagandistike dhe të rreme të 2A Group lidhur me financimin nga Delphos Securities SARL, të kundërshtuara me opinione ligjore nga kompani ndërkombëtare të auditimit financiar (BDO), si dhe me deklaratën zyrtare të vetë Delphos, e cila rrëzon çdo akuzë të 2A Group;
- Emërimin nga ortaku minoritar me vetëm 2% të kuotave të administratorit z. Vegim Hoxha, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9901/2008 dhe me statutin e VIA-s, në mungesë të kuorumit ligjor të nevojshëm dhe pasqyrimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar nga një Autoritet Kompetent (Qendra Kombëtare e Biznesit), në kundërshtim me legjisllacionin e zbatueshëm;
- Faktin se pavarësisht se më datë 22.12.2025, Gjykata e Apelit rrëzoi masat civile të sigurisë kundër Mabco-s, të nesërmen më datë 23.12.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 17959 akti (“**Vendimi i Dytë**”) rivendosi të njëjtat masa, madje edhe më të rënda, duke krijuar një precedent të papranueshëm dhe të pashembullt;
- Nevojën objektive, në mbrojtje të projektit dhe të sigurisë së pasagjerëve, për kryerjen e një auditimi teknik të pavarur të pistës së aeroportit, kërkesë e cila mbetet e paadresuar;
- Largimin nga ana e Vegim Hoxha dhe 2A Group, të punonjësve dhe ekspertëve strategjikë të nevojshëm për certifikimin e aeroportit, me pretendimin e vetëm se ata kishin raporte profesionale me Mabco-n;
- Angazhimin e Mabco-s për të garantuar vijueshmërinë e operimit aeroportual nëpërmjet operatorëve ndërkombëtarë: fillimisht Munich International Airport (MIA) dhe, pas tërheqjes së tij si pasojë e konfliktit, Dublin Airport Authority (DAA), vizita e të cilëve në kantierin e aeroportit u pengua dhunshëm nga z. Vegim Hoxha;
- Veprimet antiligjore dhe antikontraktuale të z. Vegim Hoxha, i cili, duke zbatuar udhëzimet e 2A Group ka kryer si vijon: (i) ka penguar sistematikisht punimet e Mabco-s; (ii) ka përjashtuar Mabco-n nga çdo informacion mbi ecurinë e VIA-s; (iii) ka ndërhyrë në marrëdhëniet e Mabco-s me BKT-në duke e kërcënuar bankën të mos komunikojë me Mabco-n; (iv) më datë 8 Prill 2026, ka filluar procedurat për të zgjidhur kontratën e lidhur mes VIA dhe Mabco të datës 3 Tetor 2022, të amenduar (“**Kontrata e Nënkontraktimit**”), me synimin e qartë për të larguar Mabco-n edhe *de facto* nga projekti;
- Devijimin kritik dhe të rrezikshëm në realizimin e pistës (RWY) nga nënkontraktori i 2A Group, i cili ka rezultuar në një diferencë mesatare prej rreth 10 cm nën kuotat e

parashikuara në projekt, me ndikim të drejtpërdrejtë mbi sistemet AGL, ALS, PAPI dhe mbi procesin e certifikimit;

- Keqpërdorimin e vendimeve gjyqësore nga z. Vegim Hoxha, i cili i ka keqinterpretuar qëllimisht ato me synimin e vetëm të përjashtimit të Mabco-s nga çdo marrëdhënie, përfshirë ato me BKT-në, ku Mabco është palë direkte si garantuese e vetme e projektit me asetet e veta;
- Faktin se Mabco ka lënë në dispozicion të VIA-s, që nga shtatori 2025, shumën prej 6.448.881,45 EUR, të destinuara për pajisje ICT, GSE dhe sisteme të tjera kritike për vënien në operacion dhe certifikimin e aeroportit, për të cilat z. Vegim Hoxha dhe 2A Group refuzojnë të vijnë me procedurat përkatëse;
- Nevojën e ndërhyrjes institucionale për lëshimin e autorizimeve të importit për pajisjet X-RAY, të cilat presin përfundimin e procedurave doganore prej mbi shtatë muajsh;
- Pengesat jo-ligjore të vendosura nga z. Vegim Hoxha mbi aksesin e Mabco-s dhe nënkontraktorëve të saj ndërkombëtarë në kantierin e aeroportit, përfshirë rastin e fundit (ngjarjet e datës 7-8 prill 2026) kur janë penguar fizikisht punimet e ndriçimit të pistës (sistemet AGL), edhe pasi Mabco kishte dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar artificialisht nga z. Hoxha;
- Vonesat e konsiderueshme të shkaktuara nga projektuesit X-Plan Studio, të cilët, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme teknike nga Mabco, kanë dështuar të dorëzojnë dokumentacionin e plotë dhe të zbatueshëm të projektit, vizatimet e azhurnuara dhe koordinimin ndërdisiplinor ndërmjet arkitekturës, strukturës dhe sistemeve MEP. Situata është përkeqësuar pas emërimit të paligjshëm të z. Vegim Hoxha, pasi persona të lidhur me strukturën e 2A Group kanë kontribuar aktivisht në bllokimin e proceseve vendimmarrëse dhe teknike, duke përjashtuar de facto Mabco-n nga kontrolli teknik i projektit. X-Plan ka kushtëzuar gjithashtu përditësimet e projektit me rishikimin e elementëve arkitektonikë tashmë të miratuar në nivel qeveritar, duke refuzuar bashkëpunimin për mbi një vit dhe duke e përdorur këtë si pretekst shtesë për mosdorëzim.
- Investimin total të Mabco-s në projekt, mbi 90 milionë euro, si dhe kolateralin e lënë ndaj BKT-së, me vlerë 150 milionë euro, si garantuese e vetme e huasë së projektit, të dokumentuara me akte noteriale dhe opinione ndërkombëtare audituese.

Letra e MIE-s konstaton se shkresa e datës 24 mars 2026 nuk ka marrë përgjigje nga VIA. Mabco sqaron kategorikisht se kjo heshtje **nuk i atribuohet Mabco-s**, por 2A Group dhe administratorit uzurpues z. Vegim Hoxha, i cili vepron në emër të 2A Group. Kjo për shkak të mosveprimit të Ministrisë, e cila ka detyrimin ligjor që në bazë të nenit 32 të Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat” dhe në bazë të nenit 18 të Kontratës së Konkensionit të refuzojë transferimin e interesit në masën 100% tek një palë që nuk plotëson asnjë prej kërkesave të tenderit, dhe që pavarësisht se sot kontrollon VIA-n, ka sabotuar



projektin. Ndërkohë, Mabco vetë i është drejtuar Ministrisë me mbi tridhjetë shkresa gjatë tetë muajve, pa marrë asnjë përgjigje substantive.

Sa i takon paralajmërimin në Letrën e MIE-s për mundësinë e ndërprerjes së kontratës, Mabco e vlerëson këtë si juridikisht të pambështetur dhe faktikisht të gabuar. Vonesat në zbatimin e projektit janë shkaktuar drejtpërsëdrejti nga veprimet e Autoriteteve Kompetente me efekt paralizues mbi VIA-n, si dhe nga mosveprimi i vetë Autoritetit Kontraktues për të garantuar zbatimin korrekt të Kontratës së Koncesionit. Çdo tentativë për t'ia atribuar Mabco-s përgjegjësinë për këto vonesa do të ishte, në shumicën dërrmuese të aspekteve, një devijim i papranueshëm nga realiteti faktik dhe juridik. Mabco sqaron gjithashtu se z. Vegim Hoxha, si përfaqësues i emëruar në mënyrë të kundraligjshme nga 2A Group (me pjesëmarrjen në proces të një Autoriteti Kompetent) dhe jo i interesave të VIA-s, mban personalisht, bashkë me 2A Group, përgjegjësi të plotë për çdo mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale që rrjedh nga veprimet e tij.

Megjithëse Letra e MIE-s nuk i drejtohet Mabco-s por na është përcjellë për dijeni, Mabco **konfirmon pjesëmarrjen e saj të plotë dhe aktive** në takimin operacional të datës 15 prill 2026. Theksojmë se ky takim nuk mund dhe nuk duhet të zhvillohet ekskluzivisht me VIA-n nën drejtimin e z. Vegim Hoxha, pasi kjo do të ishte njohje de facto e uzurpimit nga ana e Ministrisë. Gjithashtu shpresojmë se përfaqësuesit e MIE-s do jenë krejtësisht të përgatitur për qasjen e pritshme destruktive të VIA-s dhe 2A Group dhe nuk do të bëhen palë me ta, siç ndodhi në takimin e datës 12 janar 2026, për të cilin gjithashtu ju kemi vënë në dijeni me letrën e po të njëjtës datë. Së fundmi në lidhje me këtë takim, **ju lutemi të na e njoftoni ju ambientin konkret të zhvillimit të takimit** sepse Mabco nuk pret që VIA apo 2A Group të na njoftojnë, por përkundrazi.

Pavarësisht nga takimi i datës 15 prill, nëpërmjet kësaj shkrese Mabco kërkon zyrtarisht mbajtjen e **një takimi të veçantë**, brenda 30 ditëve pune nga data e kësaj shkrese, me Mabco-n si palë aktive dhe të pavarur, bazuar në dispozitat e Kontratës së Koncesionit. Neni 13.3 detyron palët të takohen me qëllim ekskluziv gjetjen e “*një zgjidhjeje të kënaqshme reciproke për të rivendosur Koncesionarin në pozicionin tregtar që do të kishte nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur*”. Ky është takim kontraktual i detyrueshëm me axhendë specifike, i ndryshëm dhe i pavarur nga takimi operacional i 15 prillit.

Arsyet e përmbledhura juridike dhe faktike që mbështesin kërkesat tona parashtrohen si vijon.

i. **Mabco si palë me legjitimitet të plotë për të vepruar drejtpërsëdrejti**

Mabco i drejtohet Ministrisë drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësinë e VIA-s, sepse uzurpimi i plotë i VIA-s nga 2A Group dhe administratori i emëruar paligjshëm prej saj, z. Vegim Hoxha, e ka bërë të pamundur çdo koordinim: Mabco nuk ka akses në financat, dokumentacionin apo



vendimet e VIA-s dhe nuk mund të sigurojë që administratori aktual uzurpues të veprojë në interes të projektit.

Mabco ka të drejtën dhe detyrimin kontraktual të veprojë drejtpërsëdrejti, pasi mban përgjegjësi solidare për të gjitha detyrimet e Kontratës sipas nenit 2.11 të saj. Çdo pasojë e mospërbushjes kontraktuale prek drejtpërsëdrejti Mabco-n, duke e bërë atë subjektin e vetëm me kapacitetin ligjor, financiar dhe kontraktual për të vepruar proaktivisht në mbrojtje të projektit. Mabco është, gjithashtu, garantuese e vetme e huasë me BKT, me kolateral prej 150 milionë eurosh, si dhe investitorja kryesore e projektit me mbi 90 milionë euro të investuara në kapital të gatshëm. Në këtë kontekst, është e papranueshme dhe natyrisht në kundërshtim me Kontratën e Koncesionit, ligjin për Koncesionet dhe Kodin Civil (konkretisht me nenet 422, 427, 455, 487, 489, 491, 492, 494), që një pale t'i kërkohet përmbushja e një detyrimi kontraktual dhe të mbahet përgjegjëse për mospërbushje, nëse nuk i është dhënë mundësia për ta përmbushur atë; përkundrazi, ajo është penguar në mënyrë të hapur, me veprime aktive e mosveprime të kundërligjshme, në veprimtarinë e saj.

Për më tepër, Ministria nuk mund të pretendojë se i vetmi entitet që ka të drejtën t'i adresohet Ministrisë është VIA, kur situata e krijuar, ku VIA operon si instrument i 2A Group, është shkaktuar nga vendimet e vetë Autoriteteve Kompetente, si dhe nga veprimet dhe mosveprimet e MIE-s, në shkelje të Kontratës së Koncesionit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm. MIE nuk mund të përfitojë nga fakti që shkeljet e ligjit nga ana e Autoriteteve Kompetente e kanë vënë Mabco-n në pozitë pamundësie, ku ajo nuk mund të ushtrojë as të drejtat elementare të pronësisë mbi VIA-n.

## ii. Shkelja e nenit 11.9 nga Autoritetet Kompetente

### A. Gjykatat si "Autoritete Kompetente"

Neni 1 i Kontratës përkufizon "Autoritetin Kompetent" si çdo "autoritet, ministri, agjenci, inspektoriat, departament, **gjykatë**, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision, ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkie, administrativ ose ent rregullator". Rrjedhimisht, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata e Apelit janë, pa asnjë dyshim, "Autoritete Kompetente" sipas kuptimit të Kontratës.

Neni 11.9 i Kontratës parashikon shprehimisht:

*"Në përputhje me këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues angazhohet të mos ndërmarrë asnjë veprim, dhe që asnjë Autoritet Kompetent nuk do të kryejë asnjë veprim që mund të ketë efekt material jo të favorshëm mbi Punimet, operimin e VIA-s, ofrimin e Shërbimeve Aeroportuale dhe Shërbimeve Tregtare [...]"*

Kjo dispozitë parashikon dy detyrime kumulative të Ministrisë: (i) detyrimin e vet aktiv të mos ndërhyjë negativisht; dhe (ii) detyrimin **garantues** se asnjë Autoritet Kompetent, duke përfshirë



gjykatat, nuk do të ndërmarrë veprime me efekt material të pafavorshëm mbi projektin. Komponenti i dytë nuk është thjesht detyrim mosveprimi nga ana e Ministrisë; ai është detyrim aktiv garantues i marrë nga Ministria me nënshkrimin e Kontratës, i cili nuk mund të shmanget me argumentin e pavarësisë gjyqësore.

### **B. Tri vendimet gjyqësore si shkelje e nenit 11.9**

Tri vendime gjyqësore të Autoriteteve Kompetente kanë pasur efekt material, të drejtpërdrejtë dhe të pafavorshëm mbi VIA-n dhe projektin:

- Vendimi i Parë pezulloi të drejtën e votës së Mabco-s dhe bllokoi Asamblenë e VIA-s të planifikuar për 20 tetor 2025, duke e lënë VIA-n pa administrator nga 17 tetori deri më 11 dhjetori 2025 dhe duke bllokuar ndër të tjera dhe emërimin e audituesit teknik të punimeve.
- Vendimi i Dytë, shpallur vetëm një ditë pas rrëzimit të Vendimit të Parë nga Gjykata e Apelit, pezulloi sërish të drejtën e votës dhe të gjitha të drejtat e Mabco-s si ortake, duke konsoliduar paralizimin e VIA-s.
- Vendimi nr. 30-2026-1569 i Gjykatës së Apelit i datës 19 shkurt 2026 (“**Vendimi i Tretë**”) la në fuqi Vendimin e Dytë vetëm një ditë para datës së synuar të operimit, duke kthyer atë që pretendohet të ishte masë e përkohshme në gjendje të vazhdueshme paralizimi, dhe duke kundërshtuar hapur qëndrimin e mëparshëm të po kësaj gjykate të dhënë vetëm dy muaj më parë.

Të tri vendimet, individualisht dhe kumulativisht, kanë pasur efekt material negativ mbi: (a) funksionimin operacional të VIA-s; (b) aftësinë e Mabco-s për të ushtruar të drejtat si ortake shumice dhe nënkontraktor kryesor; (c) vijimësinë e punimeve dhe procesin e certifikimit; dhe (d) aftësinë e VIA-s për të nisur operimin. Duke qenë se këto vendime janë veprime të Autoriteteve Kompetente, **Ministria është në shkelje të detyrimit garantues sipas nenit 11.9**, pavarësisht nëse vendimmarrja gjyqësore ishte drejtuar apo lejuar prej saj.

### **C. Mosveprimi i Ministrisë si shkelje e pavarur e nenit 11.9**

Pavarësisht nga efekti i vendimeve gjyqësore, Ministria ka shkelur drejtpërsëdrejti nenin 11.9 nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të veta duke:

- mos kthyer përgjigje zyrtare për pothuaj asnjë nga letrat e drejtuara zyrtarisht Ministrisë nga Mabco;
- mos ndërhyrë institucionalisht për të mbrojtur projektin ndaj uzurpimit aktiv të VIA-s nga 2A Group, ndonëse ishte informuar plotësisht dhe me dokumentacion nga Mabco gjatë gjithë kësaj periudhe;



- mos reaguari ndaj nxjerrjes me dhunë të përfaqësuesve të Mabco-s nga 2A Group dhe VIA në takimet me MIE-n dhe duke e pranuar atë si një akt krejtësisht normal, duke u bërë kështu palë me 2A Group;
- mos reaguari ndaj bllokimit fizik të Mabco-s dhe kontraktorëve të saj ndërkombëtarë nga kantieri;
- mos ndërhyrë ndaj bllokimit të zhdoganimit të pajisjeve kritike;
- mos ndërhyrë ndaj pengesave të krijuara nga VIA dhe 2A Group në lidhje me largimit të partnerëve strategjikë, si Munich International Airport dhe Dublin Airport Authority;
- adresuar komunikimet formale vetëm te VIA nën drejtimin e z. Hoxha dhe duke i dhënë Mabco-s vetëm kopje “për dijeni”, duke legjitimuar *de facto* uzurpimin dhe duke përjashtuar palën me 98% të kapitalit dhe me përgjegjësi solidare kontraktuale;
- mos mbajtur asnjë qëndrim zyrtar ndaj pretendimeve të rreme të 2A Group lidhur me financimin Delphos, të kundërshtuara plotësisht me dokumentacion të verifikuar nga Delphos dhe BDO;
- mos miratuar apo refuzuar në mënyrë të shprehur transferimet e kuotave *de jure* të kundërshtuara, ashtu si dhe transferimin e kuotave *de facto* bazuar në vendimet e Autoriteteve Kompetente, gjë që ka rezultuar në prishjen totale të kushteve mbi të cilat është zhvilluar procesi i dhënies së koncesionit, në kundërshtim me detyrimet e nenit 18 të Kontratës dhe nenit 32 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetet publik-private”.

Secila nga këto sjellje përbën shkelje të pavarur dhe kumulative të nenit 11.9, me efekt material negativ të dokumentuar mbi projektin dhe aftësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet.

### iii. E drejta e shtyrjes së afateve sipas nenit 11.10

Neni 11.10 i Kontratës parashikon:

*"Në rast ndërprerjeje të paautorizuar nga ana e Autoritetit Kontraktues ose një Autoriteti Kompetent [...] e cila shkakton vonesa në Punime, mbylljen ose pezullimin e operimit të VIA-s, Koncesionari mund të kërkojë zgjatjen e: (a) Afatit të Kontratës, për një kohëzgjatje të barabartë me kohëzgjatjen e ndërprerjes ose pezullimit të Punimeve; (b) Datës së Përfundimit të Punimeve [...]"*

Tri vendimet gjyqësore të trajtuara në Seksionin II.B janë ndërhyrje konkrete të Autoriteteve Kompetente, të cilat kanë shkaktuar drejtpërsëdrejti ndërprerje, vonesa dhe pezullim të veprimtarisë normale të VIA-s dhe punimeve, duke filluar nga 17 tetori 2025. Neni 11.10 është plotësisht i aplikueshëm dhe Mabco ka të drejtën e shtyrjes së Datës së Synuar të Nisjes së



Operimit si dhe, nëse do të jetë e nevojshme, të Afatit të Kontratës, për periudhën totale të ndërhyrjeve, duke filluar nga 17 tetori 2025 dhe deri në rikthimin e kontrollit ligjor dhe operacional mbi VIA-n.

Në ndryshim nga mekanizmat e nenit 12 dhe nenit 13 të Kontratës së Koncesionit (të cilat do t'i trajtojmë në vijim), e drejta sipas nenit 11.10 është e drejtpërdrejtë dhe automatike. Me konstatimin e ndërhyrjes nga Autoritetet Kompetente, Koncesionarit i lind e drejta të kërkojë zgjatjen pa nevojën e procedurave apo takimeve shtesë.

**iv. E drejta e shtyrjes së afateve bazuar në ngjarjen e forcës madhore (neni 12)**

Vendimi i Parë, i cili e la VIA-n praktikisht dhe juridikisht pa administrator, plotëson gjithashtu, si bazë kumulative, kriteret e nenit 12.1: (a) parandaloi VIA-n dhe Mabco-n nga përmbushja e detyrimeve; (b) ishte jashtë kontrollit të tyre, pa qenë pasojë e fajit apo neglizhencës së tyre; dhe (c) nuk mund të shmangej me kujdesin e arsyeshëm. Për më tepër, Mabco ka ndërmarrë të gjitha hapat e kërkuar nga neni 12.4: ka informuar Ministrinë menjëherë, ka sfiduar Vendimin e Parë në Gjykatën e Apelit dhe ka ndërmarrë të gjitha hapat për të lehtësuar pasojat e tij, duke kryer drejtpërsëdrejti nga fondet e saj pagesat e punonjësve të VIA-s, si dhe veprime të tjera mitiguese.

Sipas neneve 12.2 dhe 12.3, asnjëra palë nuk konsiderohet në shkelje dhe afatet pezullohen automatikisht. Mabco kërkon konfirmimin e pezullimit të afateve kontraktuale për periudhën 17 tetor – 11 dhjetor 2025 si Ngjarje e Forcës Madhore, kumulativisht me bazat e Seksioneve II dhe III.

**v. E drejta e shtyrjes së afatit bazuar në veprimin material të pafavorshëm qeveritar (neni 13)**

Të tri vendimet gjyqësore përbëjnë gjithashtu, si bazë kumulative, “*Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar*” sipas nenit 13.1, si ndërhyrje të Autoriteteve Kompetente me efekt material negativ mbi të drejtat, asetet dhe pozicionin ekonomik të Koncesionarit.

Mabco kërkon zyrtarisht që kjo shkresë të konsiderohet njoftim sipas nenit 13.3, duke angazhuar palët në takimin e veçantë të parashikuar aty brenda 30 ditëve pune, me qëllim rivendosjen e projektit në pozicionin tregtar të mëparshëm. Mabco evidenton gjithashtu se vendimet ngrenë çështje serioze edhe në kuadër të Marrëveshjes Bilaterale të Investimeve Shqipëri-Zvicër (“**BIT**”), duke privuar Mabco-n nga kontrolli efektiv i investimit të saj në mënyrë të ngjashme me shpronësim sipas Nenit 7(1), dhe duke cenuar standardet e trajtimit të drejtë sipas Neneve 4 dhe 5.



vi. **Pasojat konkrete të shkeljeve të mësipërme: pamundësia për nisjen në kohë të operimit**

Shkeljet e parashikuara në Seksionet II-V, veçmas dhe kumulativisht, kanë prodhuar pamundësi objektive të dokumentuara:

**Nga shkelja e nenit 11.9 (vendimet gjyqësore dhe pasiviteti i Ministrisë):**

- Pamundësia e kontrollit të cilësisë së punimeve, me deviacion mesatar prej rreth 10 cm nën kuotat e projektit në pistën RWY, me ndikim të drejtpërdrejtë mbi sistemet AGL, ALS, PAPI dhe mbi procesin e certifikimit;
- Shkaktimi i vonesave gjatë punimeve si pasojë e mosdorëzimit të dokumentacionit të plotë dhe të koordinuar të projektit nga X-Plan Studio e cila në bashkëpunim me 2A Group ndërhyne në koordinimin ndërmjet Mabco-s dhe X-Plan Studio, duke përjashtuar de facto Mabco-n nga kontrolli teknik i projektit dhe duke kthyer projektuesin në instrument sabotimi.
- Bllokimi fizik i Mabco-s dhe nënkontraktorëve të saj ndërkombëtarë nga kantieri (konkretisht 7-8 prill 2026, punimet e ndriçimit të pistës), edhe pasi Mabco kishte dorëzuar plotësisht dokumentacionin e kërkuar;
- Pamundësia e zhdoganimit të pajisjeve kritike (sisteme zjarrfikëse dhe X-ray prej mbi shtatë muajsh) dhe bllokimi i shumës prej 6.448.881,45 EUR të destinuara për pajisje ICT, GSE dhe sisteme të tjera operacionale;
- Pamundësia e certifikimit të terminalit nga Dublin Airport Authority (DAA), pengesa fizike e vizitës së të cilëve u krye nga z. Vegim Hoxha; dhe
- Nisja e procedurave për zgjidhjen e Kontratës së Nënkontraktimit nga z. Vegim Hoxha (8 prill 2026), me synimin e qartë të largimit de facto të Mabco-s nga projekti.

**Nga Forca Madhore (periudha 17 tetor – 11 dhjetor 2025):**

- Pamundësia e çdo vendimmarrjeje operative të VIA-s për 55 ditë radhazi;
- Ndërprerja e shkëmbimit të informacionit me Inxhinierin e Pavarur dhe e procedurave sipas Shtojcës 32 të Kontratës;
- Pamundësia e lidhjes së kontratave me palë të treta të nevojshme për certifikimin e aeroportit; dhe
- Pamundësia e pagesës së detyrimeve të VIA-s ndaj punonjësve, autoriteteve tatimore dhe palëve të treta, detyrime të cilat u mbuluan drejtpërsëdrejti nga fondet e Mabco-s.

vii. **Sqarim i fundit në lidhje me ecurinë e punimeve**

Mabco ka marrë dijeni të konstatimeve të Inxhinierit të Pavarur mbi vonesa në punime, të cilat referohen dhe në Letrën e MIE-s, dhe i merr ato seriozisht. Megjithatë, ato duhet të kontekstualizohen me kujdes. Çdo vonesë e evidentuar pas 17 tetorit 2025 është pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së nenit 11.9 dhe shkeljes së nenit 13 të Kontratës së Koncesionit: bllokimi i aksesit, bllokimi i pajisjeve, largimi i partnerëve, sabotimi i certifikimit, pengimi i sistemeve AGL. Konstatimet e Inxhinierit të Pavarur nuk mund të shërbejnë si argument kundër shtyrjes kur shkaku rrënjësor i çdo vonese është pikërisht ndërhyrja e Autoriteteve Kompetente dhe mosveprimi i Ministrisë, siç argumentohet në Seksionin II.

Përveç sa më lart, Mabco ka kapacitete të fuqishme të demonstruar gjatë gjithë historikut të saj. Mabco është shoqëri zvicerane me aktivitet global në industrinë ndërtimore, me portofol ndërkombëtar që përfshin projekte aeroportuale të realizuara me sukses në mjedise juridike dhe operative ndër më sfidueset në botë, me standardet më rigoroze të ndërtimit dhe certifikimit. Mabco ka investuar drejtpërsëdrejti në projektin VIA mbi 90 milionë euro, ka lënë kolateral ndaj BKT-së aktive 150 milionë euro dhe ka bllokuar të gatshme 6.448.881,45 euro në llogaritë e VIA-s për pajisje operationale. Kontraktorët ndërkombëtarë specialistë ishin tashmë të angazhuar; si Aeroporti i Mynihut ashtu dhe Dublin Airport Authority treguan gatishmëri për të marrë menaxhimin operational vetëm në sajë të lidhjeve të Mabco-s, pavarësisht nga veprimet e kundraligjshme të 2AGroup dhe VIA-s së komanduar prej tyre. Kufizimi i Mabco-s nuk ka qenë kurrë financiar apo teknik. Ka qenë ekskluzivisht operational, i shkaktuar nga humbja e kontrollit mbi VIA-n.

Së fundmi, edhe sikur VIA të kishte qenë relativisht prapa grafikut në gusht 2025, kjo vonesë nuk kishte asnjë karakter strukturor apo të pakthyesëm. Projektet ndërtimore të kësaj shkalë dhe kompleksiteti shpesh përfundohen me pershpejtim intensiv të fazave të fundit, dhe Mabco ka kapacitetin e nevojshëm për ta bërë këtë. Që nga muaji Tetor 2025, kohë në të cilën Mabco kerkoi mbledhjen e asamblesë për auditimin teknik dhe financiar të aktivitetit të VIA-s, me qëllim konstatimin e progresit dhe marrjen e masave të nevojshme sipas Kontrates së Koncesionit, kishte mjaftueshëm kohë për të finalizuar procesin e certifikimit dhe do të kishte respektuar afatin kontraktual. Ky nuk është pohim teorik, por projektion i drejtpërdrejtë i kapacitetit të demonstruar të Mabco-s si ndërtues dhe investitor global.

Mabco është e gatshme të paraqesë, në takimin e veçantë sipas nenit 13.3 (dhe pasi të ketë marrë informacion të plotë në takimin e datës 15 Prill), një plan pune të detajuar dhe të verifikueshëm për përfundimin e projektit, duke treguar fazë pas faze se si dhe brenda cilave afate mund të mbarojë ndërtimi, certifikimi dhe nisja e operimit, duke filluar nga momenti kur Mabco rifiton kontrollin operational si pronare e 98% të VIA-s. Ky plan do të përfshijë burimet konkrete të mobilizueshme, kontraktorët e gatshëm, axhendën e certifikimit dhe afatet realiste të çdo hapi deri në Operation Date.



viii. **Kërkesat e Mabco**

Bazuar në gjithë sa më sipër, Mabco kërkon zyrtarisht nga Ministria:

1. **Garantimin e pjesëmarrjes aktive dhe të barabartë të Mabco-s** në takimin e 15 prillit 2026 (duke na njoftuar dhe për vendtakimin), me axhendë që reflektojë shpërndarjen e plotë të informacionit në lidhje me gjendjen reale të projektit në mënyrë që dhe Mabco të arrijë të përlogarisë realisht planin e vet të veprimit;
2. **Konfirmimin e shtyrjes së Datës së Synuar të Operimit dhe afateve kontraktuale sipas nenit 11.10**, për periudhën totale të ndërhyrjeve nga Autoritetet Kompetente (gjykatat), duke filluar nga 17 tetori 2025 dhe deri në rikthimin e kontrollit ligjor të Mabco-s mbi VIA-n;
3. **Konfirmimin e pezullimit të afateve kontraktuale për periudhën 17 tetor – 11 dhjetor 2025** si Ngjarje e Forcës Madhore sipas nenit 12, kumulativisht;
4. **Njohjen e situatës si Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar sipas nenit 13** dhe mbajtjen e takimit të veçantë sipas nenit 13.3 brenda 30 ditëve pune nga kjo shkresë, me Mabco-n si palë aktive dhe të pavarur; dhe
5. **Ndërmarrjen e masave institucionale të menjëhershme**, duke garantuar aksesin e Mabco-s dhe nënkontraktorëve të saj ndërkombëtarë në kantierin e aeroportit dhe duke ndërhyrë institucionalisht ndaj uzurpimit.

Mabco konfirmon angazhimin e saj të palëkundur për realizimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës si projekt strategjik kombëtar. Siç u parashtua në Seksionin VII, Mabco ka kapacitetin e plotë financiar, teknik dhe njerëzor për ta përfunduar projektin dhe është e gatshme të paraqesë një plan pune konkret dhe të verifikueshëm sapo të rikthejë kontrollin operacional mbi VIA-n. Ky angazhim nuk është deklarativ: ai mbështetet mbi ekspertizën e një kompanie globale me historik të provuar në projekte aeroportuale ndërkombëtare. Mabco rikujton se çdo veprim apo mosveprim që cenon realizimin e këtij investimi do të marrë përgjigjen e plotë juridike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në përputhje me Kontratën e Koncesionit, BIT-in Shqipëri-Zvicër dhe legjislacionin e zbatueshëm.

Me respekt,

**MABCO CONSTRUCTIONS SA**

Kryetari i Këshillit të Administrimit

**Emin Pacolli**

**MABCO CONSTRUCTIONS SA**

Via Cattori 7

CH - 6902 Lugano -Paradiso

